

VENDIM
Nr. 304, datë 20.4.2016

PËR SHPALLJEN E LAGUNËS SË NARTËS SI ZONË BASHKËMENAXHUESE
PESHKIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 54, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e Lagunës së Nartës si zonë bashkëmenaxhuese peshkimi, për të ushtruar aktivitetin e peshkimit tradicional.
 2. Plani i bashkëmenaxhimit për Lagunën e Nartës miratohet me urdhër të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, brenda 12 muajve nga data e miratimit të kësaj zone.
 3. Veprimtaritë dhe investimet që do të kryhen në Lagunën e Nartës të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura dhe me objektivat e planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur të Lagunës së Nartës.
 4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama